



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 917/8 prot.

Tiranë, më 16.07.2026

V E N D I M

Nr. 25, datë 16.07.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës nr. 917 prot., datë 31.03.2026 (vijuar me nr. 917/3 prot., datë 28.04.2026, nr.917/5 prot., datë 28.05.2026 dhe nr. 917/7 prot., datë 30.06.2026), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare” kundër Autoritetit Publik/Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 13.02.2026, depozituar në adresën elektronike fatbardha.gjaci@ekonomia.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

Sipas njoftimit në Buletinin e APP, nr. 10, datë 02.02.2026, lutem të më vendosni në dispozicion dokumentet e mëposhtme:

- 1- Listën e subjekteve pjesëmarrëse në këtë procedurë konkurrimi dhe emrin e subjektit të shpallur fitues;
- 2- Procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, ku pasqyrohen pikët e marra nga secili konkurrent për tri kriteret e shpallura: investimin, punësimin dhe tarifën e qirasë;
- 3- Kopje të planit të biznesit të fituesit, ku të përfshihet përshkrimi i projektit të investimit, shërbimet që do të ofrohen në territorin e spitalit, burimet financiare dhe niveli i premtuar i punësimit;
- 4- Kopje të kontratës së qirasë, nëse kjo kontratë është firmosur tashmë mes palëve (ose urdhrin e shpalljes së fituesit nëse jeni ende në fazë ankimi);

5- *Dokumentacionin nismëtar/kërkesën që ka argumentuar nevojën e dhënies me qira të kësaj hapësire brenda territorit të QSUT “Nënë Tereza”.*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 917 prot., datë 31.03.2026, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 917/1 prot., datë 21.04.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it të datës 24.04.2026 dhe shkresës nr. 3540/1 prot., datë 28.04.2026, i ka kthyer përgjigje Zyrës së Komisionerit dhe ankuesit, duke e informuar se: “*...Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, lidhur me kërkesën për vënie në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit zyrtar mbi procedurën e dhënies me qira të pasurisë shtetërore me nr.1/313, ZK 8130, me sipërfaqe 467.48 m², në përgjegjësi administrimi të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, sqarojmë si më poshtë: Dokumentacioni i kërkuar, konkretisht lista e subjekteve pjesëmarrëse, procesverbali i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, plani i biznesit i subjektit fitues, si dhe kopja e kontratës së qirasë, përbëjnë dokumente të brendshme të institucionit dhe, në referim të legjislacionit në fuqi, nuk parashikohet shpërndarja e tyre për publikun. Sa i përket informacionit mbi shpalljen e fituesit, në zbatim të VKM-së nr. 54/2014, i ndryshuar, ky informacion bëhet publik në këndin e njoftimeve zyrtare të institucionit, në rastet kur në procedurë kanë marrë pjesë më shumë se një ofertues. Në lidhje me kërkesën fillestare, sqarojmë se procedura për dhënien me qira është iniciuar nga institucioni administrues i pasurisë, i cili në çdo rast përcjell dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se shqyrtimi i kërkesës dhe kthimi i përgjigjes ka pësuar vonesë edhe për shkak se në momentin e paraqitjes së kërkesës suaj, procedura e konkurrimit ka qenë ende në zhvillim dhe në fazë shqyrtimi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda afateve ligjore të parashikuara...”.*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të e-mail-it të datës 28.04.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 917/3 prot., datë 28.04.2026, ka vijuar ankimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 917/4 prot., datë 08.05.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi, z. _____, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. Fatbardha Gjaci, në cilësinë e koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, znj. Uendi Hysenllari, në cilësinë e përgjegjëses në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit të Pronës Shtetërore dhe z. Alqi Kushi, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Pronës Shtetërore, kërkuar kohë për të rivlerësuar qëndrimin e Autoritetit Publik.

Ankuesi, nëpërmjet e-mail-it të datës 28.05.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 917/5 prot., datë 28.05.2026, ka vijuar ankimin, duke sqaruar se: *“...në vijim të seancës dëgjimore... sot 1 javë me vonesë, ne ende nuk e kemi përgjigjen që u sanksionua se do të jepej...”*.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it të datës 08.06.2026, ka njoftuar ankuesin, duke vënë në dijeni edhe Zyrën e Komisionerit se : *“...Në vijim të komunikimeve mbi kërkesën dhe pretendimet e z. _____, lidhur me procedurën e dhënies me qira të pasurisë shtetërore me nr. 1/313, ZK. 8130, me sipërfaqe 467.48 m², në përgjegjësi administrimi të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ju vëmë në dijeni se z. _____ ka marrë përgjigje nga MEI, sipas e-mail-it të datës 03.06.2026, sa me poshtë vijon ...Në vijim të komunikimeve lidhur me kërkesën Tuaj, në kuadër të së drejtës për informim, ju bëjmë me dije se: Në mbështetje të nenit 2, pika 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”, është vënë në dispozicion dokumentacioni që klasifikohet si i tillë nga ana e autoritetit publik. Sa i përket planbiznesit të paraqitur në procedurë, vlerësojmë se ky dokument përbën një akt konfidencial, pasi përfshin të dhëna personale të ofertuesit. Nga ana tjetër, në lidhje me procesverbalin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ky dokument përbën akt të brendshëm administrativ të institucionit, i cili është hartuar në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, për këtë arsye, ky dokument nuk është pjesë e dokumentacionit që vihet në dispozicion në kuadër të kërkesës për informim. Së fundmi, në lidhje me kontratën e qirasë, ju informojmë se ajo i është vënë në dispozicion njësisë administruese të pasurisë shtetërore, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e për rrjedhojë, mund t’i drejtoheni kësaj të fundit. Për sa më sipër, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion kërkesën fillestare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale...”*.

Ankuesi, nëpërmjet e-mail-it të datës 29.06.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 917/7 prot., datë 30.06.2026, ka vijuar ankimin, duke kërkuar informacionin/dokumentacionin sipas kërkesës për informacion të datës 13.02.2026.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike*”.

Konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar se: *“në lidhje me kontratën e qirasë, ju informojmë se ajo i është vënë në dispozicion njësisë administruese të pasurisë shtetërore, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e për rrjedhojë, mund t'i drejtoheni kësaj të fundit...”, Komisioneri vëren se ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim të plotë me parashikimet e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: “Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik e ka administruar kontratën e sipërcituar, si pasojë, në bazë të nenit të lartpërmendur, pavarësisht se e ka dërguar pranë një Autoriteti Publik tjetër, nuk mund të përjashtohet nga zbatimi i parashikimeve të LDI-së.

Konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar se: *“...sa i përket planbiznesit të paraqitur në procedurë, vlerësojmë se ky dokument përbën një akt konfidencial, pasi përfshin të dhëna personale të ofertuesit... në lidhje me procesverbalin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ky dokument përbën akt të brendshëm administrativ të institucionit, i cili është hartuar në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave...”, lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI-së, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë të nenit të sipërcituar.*

Neni 17 i LDI-së, në pikën 6 të tij parashikon se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Për sa cituar më sipër, Autoriteti Publik nuk mund të refuzojë në tërësi kërkesat e ankuesit, duke cituar se: “...përbën një akt konfidencial, pasi përfshin të dhëna personale të ofertuesit...” dhe “ky dokument përbën akt të brendshëm administrativ të institucionit, i cili është hartuar në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave...”, pa analizuar në tërësi legjislacionin e sipërcituar.

Autoriteti Publik, duke qenë se dokumentet e mësipërme bëhen pjesë e dosjes së paraqitur pranë Autoritetit Publik, në respekt të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, në kreun II, nenet 7 dhe 8, përcaktojnë dokumentacionin e nevojshëm që duhet paraqitur: “7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban: a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit. b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm: - Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen; - Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit; - Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij; - Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara. Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër. c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon: - Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues; - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore; - Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin; - Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore; - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues. Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim. 8. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë, që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare, i dorëzohet komisionit dhe përmban: a) Kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit kryesorë financiarë të parashikuar sipas planit të biznesit; b) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues; c) Planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës; ç) Përshkrimin e projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit; d) Deklaratat, në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon: - Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit

kërkues; - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore; - Deklaratë për administratorin dhe për subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin; - Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore; - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues...”.

Gjithashtu, edhe lista me subjektet pjesëmarrëse, duke përfshirë subjektin e shpallur fitues nga ky prokurim publik, procedurë tashmë e përfunduar, është dokumentacion i cili është administruar nga Autoriteti Publik dhe në kushtet kur procedura ka përfunduar nuk ka mundësi që të cenojë prokurimin publik.

Ndër të tjera, Autoriteti Publik duhet të ketë parasysh se në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të dhënat e subjektit fitues tashmë janë shpallur, duke u bërë publike.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë, pika 3 e nenit 3 të LDI-së parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért* kundër Hungarisë (aplikimi nr. 37374/05, datë 14.04.2009) vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 917 prot., datë 31.03.2026 (vijuar me nr. 917/3 prot., datë 28.04.2026, nr. 917/5 prot., datë 28.05.2026 dhe nr. 917/7 prot., datë 30.06.2026), ndaj Autoritetit Publik, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës datë 13.02.2026, konkretisht: “1. *Listën e subjekteve pjesëmarrëse në këtë procedurë konkurrimi dhe emrin e subjektit të shpallur fitues; 2. Procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, ku pasqyrohen pikët e marra nga secili konkurrent për tri kriteret e shpallura: investimin, punësimin dhe tarifën e qirasë; 3. Kopje të planit të biznesit të fituesit, ku të përfshihet përshkrimi i projektit të investimit, shërbimet që do të ofrohen në territorin e spitalit, burimet financiare dhe niveli i premtuar i punësimit; 4. Kopje të kontratës së qirasë, nëse kjo kontratë është firmosur tashmë mes palëve (ose urdhrin e shpalljes së fituesit, nëse jeni ende në fazë ankimi); 5. Dokumentacionin nismëtar/kërkesën që ka argumentuar nevojën e dhënies me qira të kësaj hapësire brenda territorit të QSUT “Nënë Tereza”*”, brenda datës 24.07.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë më 16.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi